

Rikthehen 10 ikonat e vjedhura “në vendin e tyre”



Fortlumtura e tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, † Joani, u prit nga Ministri i Kulturës, Turizmit dhe Sporteve z. Blendi Gonxhja, i cili i dorëzoi 10 ikonat e kishës së Fjetjes së Hyjlindëses të Labovës së Kryqit

Gjatë takimit, në fjalën e tij, Ministri z. Blendi Gonxhja theksoi: Sot kam kënaqësinë të mirëpres një vizitor të veçantë në Ministrinë tonë, Fortlumturinë e tij, Kryepiskopin Joan. Për një arsye sa kulturore dhe shpirtërore. Falë një operacioni të suksesshëm të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitutional, u bë i mundur shpëtimi nga trafikimi i pasurive me vlera kulturore kombëtare. Ekspertët identifikuan 10 ikona të vjedhura nga kisha “Fjetja e Shën Mërisë” në Labovën e Kryqit, të cilat sot po i rikthehen Kishës Orthodhokse pas 14 vitesh mungesë. Jo vetëm u “shpëtuan” nga trafikimi pasuritë kulturore, por është edhe një shembull shumë domethënës suksesi, i cili dëshmon qartë sesa jetik është regjistrimi i pasurive kulturore si mjeti i vetëm dhe i besueshëm për identifikimin e origjinës së tyre, në rastet kur ato rrezikojnë të trafikohen apo humbasin. Ky rikthim nuk është vetëm një akt ligjor, por një akt drejtësie historike dhe shpirtërore. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe me Kryepiskopin dhe të gjitha komunitetet e tjera fetare, do të vijojë pa ndërprerje, me qëllim gjetjen dhe rikthimin e objekteve të tjera të deklaruara të humbura, në një angazhim të pa

kompromis për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore. Qëllimi ynë është i qartë, të mbrojmë trashëgiminë tonë kulturore, ta restaurojmë dhe t'i japim identitetin e merituar vendit tonë në këtë mozaik unikal të trashëgimisë kulturore.

“Jam i gëzuar që ndodhem këtu, për rikthimin e një pjese shumë të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, – tha në fjalën e tij Kryepiskopi Joan. Dua të falënderoj të gjithë ata njerëz që i gjetën dhe i mblodhën 10 ikona shumë të bukura dhe shumë të rëndësishme për historinë tonë, dhe sidomos jam shumë mirënjohës ndaj Ministrit, i cili pati angazhimin, dëshirën për t’ia kthyer përsëri Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Ne jemi të gjithë të angazhuar për ta mbrojtur këtë kulturë e këtë identitet dhe kjo është një nga pasaportat tona edhe për identitetin tonë europian, e të kulturës europiane. Besoj se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më tej për të mirën e të gjithëve. I falënderoj të gjithë edhe njëherë ata persona të cilët i gjetën dhe i kthyen përsëri në vendin e tyre këto ikona kaq shumë të rëndësishme”.

Biseda me Kryepiskopin Joan u ndal edhe në punët e tjera konkrete të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtorive Rajonale, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore lidhur me restaurimin dhe ruajtjen e kishave dhe manastireve që janë monumente kulture. U diskutua harta e gjerë e punëve në territor si dhe mundësitë e bashkëpunimit sa më të ngushtë për mbrojtjen më efikase të trashëgimisë. Fortlumturia e tij, Kryepiskopi Joan shprehu mirënjohjen ndaj Ministrit për aktin e kthimit të ikonave dhe për vijimin e punëve të tjera konkrete. Së bashku ritheksuan që bashkëpunimi me të gjitha komunitetet fetare, si mbartëse dhe kujdestare fizike dhe shpirtërore të objekteve fetare monument kulture ka vlerë dhe rëndësi të veçantë.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)